

Sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT sh.a është i vogël por nyje shumë e rëndësishme e transmisionit në Ballkan dhe Evropën Jug-Lindore

kostt

KOSTT sh.a

Rr. Iljaz Kodra pn
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel:+ 381 (0) 38 501 601 5
Fax: + 381 38 500 201
E-mail: info@kostt.com
www.kostt.com

Janar 2009

OPERATOR SISTEMI, TRASMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.

kostt

Operimi i Sistemit të Transmisionit të Kosovës

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a, është themeluar me 1 korrik të vitit 2006. KOSTT sh.a është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në bazë të obligimeve që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore.

I emëruar nga Qeveria dhe i liçensuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në tetor të vitit 2006, KOSTT sh.a është pronare e dy liçensave:

- për Operim të Sistemit të Transmisionit
- për Operim të Tregut të energjisë elektrike.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a është kompani publike e cila merret me planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë..

KOSTT është përgjegjës për transmisionin e energjisë elektrike të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV dhe po ashtu është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimit të energjisë elektrike.

Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës



Sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT është i vogël por nyje shumë e rëndësishme e transmisionit në Ballkan dhe Evropën Jug-Lindore, e me këtë edhe të sistemit energjetik të SETSO (Southeastern Europe Transmission System Operators).

Rrjeti i transmisionit të Republikës së Kosovës operon me tri nivelet e tensioneve, 400kV, 220kV dhe 110kV dhe Kosova si zonë elektroenergjetike është e ndërlidhur, përmes linjave ndërkufitare (interkonektive) me katër shtetet fqinje: Serbi, Maqedoni, Mali i Zi dhe Shqipëri.

Përbërja e Rrjetit të Transmisionit

KOSTT sh.a është pronare e rrjetit të transmisionit të tensionit të lartë të Republikës së Kosovës dhe përbëhet nga:

Linjat në bazë të nivelit të tensionit	Gjatësia totale në [km]
NIVELI 400 kV	181.356
NIVELI 220 kV	361.83
NIVELI 110 kV	643.50

Nënstacione Elektrike

- 1 Nënstacion 400/220 kV me kapacitet të transformatorëve 3x400 MVA
- 3 Nënstacione 220/110 kV me kapacitet të transformatorëve 4x150 +100 =1000MVA
- 1 Stacion shpërndarës 220kV
- 1 Nënstacion 220/35/10 kV vetëm fushat 220kV;
- 24 Nënstacione 110/(35 ose 10) kV vetëm fushat 110kV

Pasqyra e Rrjetit të Transmisionit

Rrjeti i transmisionit të Kosovës është zhvilluar gjatë 50 viteve te fundit në disa faza të ndërtimit, zgjerimit, përforcimit dhe konsolidimit. Ndërtimi i linjës së parë 110 kV (kilovolt) ka filluar në vitin 1953-1958, ndërkaq në 20 vitet vijuese është zhvilluar tutje rrjeti i 110 kV si dhe ai 220 kV dhe 400 kV, duke vazhduar me ndërtimin e linjës së fundit interkonektive në vitin 1988. Megjithatë, për më se 10 vite, gjatë vieteve të 90ta ka pasur mungesë të investimeve si në linja po ashtu edhe në transformatorë.



Vlera e përgjithshme e investimeve në rrjetin transmetues të Kosovës prej vitit 2000-2008 është afërsisht 83 Milion Euro.